REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 300, Datë 20.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 02, DATË 06.01.2025 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "DESLA" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3067 prot., datë 14.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 02, datë 06.01.2025"Mbi licencimin e shoqërisë "DESLA" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "DESLA" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 02, datë 06.01.2025, vendosi të licencojë shoqërinë "DESLA" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se "*Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 09.04.2027*".

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kuadër të rakordimit të kushtit të vendimit të sipërcituar shoqëria ka depozituar informacion në lidhje me ndërtimin e centralit, e në vijim ka bërë me dije dhe për energjizimin e tij.
- Po ashtu, nga të dhënat që ERE disponon në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria "DESLA" sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin maj 2026, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të sipërcituar, ndaj, *rezulton se kushti është plotësuar dhe vlerësohet të shfuqizohet.*

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2 të vendimit nr. 02/2025, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 3 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: "*Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi*".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 02, datë 06.01.2025, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimit, shfuqizohet.
   b) Pika 3 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:

   3. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "DESLA" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a,. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI